

**Dr. sc Rexhep Murati, profesor i rregullt<sup>1</sup>**

## **BIOGRAFIA DHE BIBLIOGRAFIA**

### **Të dhënat personale**

Dr. Rexhep Murati u lind më 14.08.1950 në Hajkobilë, Komuna e Prishtinës. Shkollën fillore dhe atë të mesme (gjimnazin) e kreu në Prishtinë. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës me 27.03.1974.

## **II**

### **Përvoja profesionale dhe angazhimet e tjera**

Pas diplomimit u punësua në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ku kreu stazhin e praktikantit.

Në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, filloi punën më 01.01.1977, në thirrje të asistentit në lëndën: “E drejta e procedurës penale”.

Studimet postdiplomike i ndoqi në Fakultetin Juridik të Beogradit, në drejtimin juridiko-penal. Më 24. 12. 1985 magjistroi në temën me titull: “Paditësi i autorizuar në procedurën penale jugosllave.” Në të njëjtin Fakultet paraqiti tezën e doktoraturës në temën me titull: “Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja.” Këshilli për studime postdiplomike i këtij Fakulteti në mbledhjen e mbajtur më 21.01. 1988 i lejoi punën në këtë temë të disertacionit.

Në vitin 1987, (prej 29 shtator gjerë më 29 dhjetor) si bursist i Bashkësisë Krahinore për punë shkencore të Kosovës ishte në specializim në ish-BRSS, të cilin e realizoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Kijevit.

Pas përjashtimit të dhunshëm nga lokalet e Fakultetit Juridik, si pasojë e dhunës serbe ndaj mësimit në gjuhën shqipe, së bashku me kolegë të tjerë mbështet përpjekjet për organizim sa më të shpejtë të mësimit në gjuhën shqipe, si në Fakultetin Juridik ashtu edhe në gjithë Universitetin e Prishtinës, studime që për gati një deçenie u zhvilluan jashtë lokaleve të uzurpuara universitare. Gjatë kësaj periudhe ishte edhe anëtar i Kuvendit të Universitetit të Prishtinës.

Në Fakultetin Juridik të Prishtinës, në thirrje të ligjëruesit për lëndën: “E drejta e procedurës penale” zgjedhet më 03.10.1996.

Për shkak të rrethanave të krijuara me ngjarjet tragjike në procesin e shkatërrimit të Jugosllavisë (ish-RSFJ-së), nuk ka arritur ta mbrojë temën e doktoratës në Fakultetin Juridik të Beogradit, prandaj të njëjtën, në fillim të vitit 2001 e ka paraqitur në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës, të cilën e ka mbrojtur më 07.04.2006 para Komisionit në këtë përbërje: Prof. Dr. Hajrija Sjerčić-Čolić, Fakulteti Juridik i Universitetit të Sarajevës, Prof. dr. Berislav Pavišić, Fakulteti Juridik i Universitetit të

---

<sup>1</sup> Të dhënat biografike dhe bibliografike mbështetën në raportet e Komisionit recenzues.

Rijekës (mentor), dhe Prof. dr. Zvonimir Tomić, Fakulteti Juridik i Universitetit të Sarajevës.

Promovimi i doktoratës është bërë me 16.11.2006 në Universitetin e Sarajevës.

Diploma e doktoratës i është nostrifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Teknologjisë me Certifikatën nr. 07/2008 të dt. 02. 01. 2008.

Me vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës nr. 1/472 të datës 22. 05. 2007 emërohet në thirrje profesor asistent.

Me vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës nr. 1/886 të datës 22. 07. 2008 emërohet në thirrje profesor i asocuar.

Me vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës nr. 276 të datës 29. 01. 2013 emërohet në thirrje të profesorit të rregullt.

Përveç gjuhës amtare dhe gjuhës serbe të cilën e flet dhe e shkruan shërbehet edhe me gjuhën kroate, boshnjake, ruse dhe angleze.

Dr. Rexhep Murati, krahas punës arsimore pedagogjike dhe profesionale shkencore, ushtroi detyra me përgjegjësi në Fakultet dhe jashtë tij dhe zhvilloi këto aktivitete:

- Kryeredaktor i Revistës për Çështje Juridike dhe Shoqërore të Fakultetit Juridik në Prishtinë “E Drejta” gjatë viteve 1997 dhe 1998;
- Prodekan i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës prej 01.01.1999 e deri më 28.07.1999;
- Ushtrues i Detyrës së Dekanit të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës prej 29.07.1999 e deri më 09.08.2000;
- Anëtar i Komisionit Këshillëdhënës Gjyqësor për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të themeluar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Kushner, gjatë vitit 1999 dhe 2000;
- Anëtar i Senatit të Universitetit të Prishtinës, në një mandat (2003-2004).
- Koordinator i Konferencës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me titull: “*Deklarata Universale për të drejtat e njeriut: Rasti i Kosovës*” të mbajtur me 23 dhe 24 tetor 2008 në hotelin Grand në Prishtinë, të organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të të Universitetit Bergamos të Italisë dhe me Fakultetin Juridik të Universitetit të Rijekës të Kroacisë, me rastin e 60 vëtorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Shef i katedrës penale-juridike në Fakultetin Juridik të UP-së (dy mandate);
- Koordinator i Projektit të Programit Klinik në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, të cilin e mbështetë ABA/CEELI ndërkaq e financon USAID-i)
- Anëtar i Këshillit Programor të Institutit Gjyqësor të Kosovës
- Udhëheqës i programit të studimeve të doktoratës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës

Me qëllim të këmbimit të përvojave, prej 8 tetorit deri më 6 nëntor 2000, udhëhoqi delegacionin e Fakultetit Juridik të Prishtinës në vizitë disa fakulteteve juridike të SHBA-ve. Me atë rast u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me: Fakultetin Juridik

Çikago Kent në Çikago (shteti i Ilinoit), me Fakultetin Juridik të Universitetit të Minesotës në Minneapolis (shteti i Minesotës), me Fakultetin Juridik të Detroitit të Universitetit shtetëror të Miçigenit në Lansing (shteti i Miçigenit) dhe me Fakultetin Juridik privat Tomas Kuli në Lansing (shteti i Miçigenit).

Më 16 dhe 17 prill të vitit 2004 mori pjesë në simpoziumin shkencor ndërkombëtar të mbajtur në Çikago të SHBA-ve, në temën: Statusi Final i Kosovës: të organizuar nga Chicago-Kent College of Law, Illinois Institute of Technology.

Prej 23 deri më 29 tetor të vitit 2004 bashkë me një delegacion të Fakultetit Juridik të Prishtinës qëndroi në Pittsburgh të SHBA-ve, në bazë të marrëveshjes për bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Pittsburgut.

Prej 22 deri më 30 maj të vitit 2005 qëndroi me një delegacion në Chicago–Kent College of Law të SHBA-ve për të ndjekur një trajnim të Mësimit Klinik.

Prej 9-13 korrik 2006, mori pjesë në Konferencën Vjetore të ABA/CEELI-t e cila u mbajt në Stamboll (Turqi).

Prej 23- 26 maj të vitit 2007 mori pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare të mbajtur në Universitetin e Orebro në Suedi.

Më 5. prill 2008 ka marr pjesë në kolokviumin shkencor ndërkombëtarë, *Quo vadis jus kriminale* i cili është mbajt në Rjekë në Republikën e Kroacisë me rastin dhjetëvjetorit të Institutit për Shkencat Penale të Moshqenices të Fakultetit Juridik të Universitetit të Rjekës. Në këtë tubim është prezantuar botimi *Decennium Moztanicense*, ku është përfshirë edhe punimi dr. Rexhep Muratit.

Me 2 dhe 3 tetor 2008 në kuadër të një delegacioni të Institutit gjyqësor të Kosovës, ishte në një vizitë studimore në Shqipëri (në Shkollën e magistraturës në Tiranë, Gjykatën e lartë dhe Prokurorinë e Përgjithshme të Shqipërisë).

Me 11- 15 nëntor 2008 në kuadër të një delegacion të Institutit gjyqësor të Kosovës, ishte në një vizitë studimore në Francë (në Këshillin e Evropës, Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, dhe Shkollën e magistraturës në Paris).

- Nga 2 - 8 maj 2010 në kuadër të një delegacion të Institutit gjyqësor të Kosovës, ishte në një vizitë studimore në Hungari (në Akademinë Gjyqësore në Budapest) dhe në Francë (në Shkollën Kombëtare të Magistraturës në Paris).

Me 30. 06. 2010, në Tryezën e organizuar nga Friedrch Naumann Stiftung në bashkëpunim me Lidhjen e Juristëve të Kosovës në kuadër të tematkës: “*Gjendja ne sistemin gjyqësor të Kosovës*”, (të mbajtur në hotelin “Ora” në Prishtinë), mbajti referatin me titull: *Disa aspekte të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë*.

- Me 22. 06. 2010, me GTZ-në, në koautorësi me prof. dr. Ejup Sahitin dhe mr. Xhevdet Elashanin, gjyqtarë i Gjykatës së Qarkut në Prizren, nënshkrojë kontratën trevjeçare për të hartuar Kodin e procedurës penale të Kosovës (në dorëshkrim).

- Në Konferencën shkencore ndërkombëtare në temën më titull: “*Mbrojtja juridiko penale e dinjitetit njerëzor në epokën e globalizimit* ” të mbajtur më 11-13. 10. 2010 në Prishtinë, paraqiti kumtesën me titull: “*Sistemi penal gjyqësor në Kosovë dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në procedurën penale*”.

- Në Seminarin shkencor në temën me titull: “*Evolucioni dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në Europë (Të drejtat civile dhe religjioze)- L’ evoluzione dei diritti umani e la loro protezione in Europa (Diritti civili e religiosi)*” të mbajtur më 10 e 11 dhjetorë 2010, të organizuar nga Ketedra e UNESCO-s në Universitetin e Bergamos në

Itali, paraqiti kumtesën me titull:” *Disa aspekte të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në procedurën penale* “

- Nga 1- 6 maj 2011 në kuadër të një delegacioni të Institutit gjyqësor të Kosovës, ishte në një vizitë studimore në Francë në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës në Bordo.

- Nga 28- 31 janar 2013 në kuadër të një delegacioni të Institutit gjyqësor të Kosovës, ishte në një vizitë studimore në Gjermani në Akademinë Gjyqësore Gjermane, në Wustrau.

Aktualisht është:

- Anëtar i Kryesisë së Shoqatës së Juristëve të Kosovës
- Anëtar i Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës (në dy mandate);
- Anëtar i Këshillit të doktoratës në Fakultetin Juridik të UP-së

### III

#### **Veprimtaria arsimore pedagogjike**

Dr. Rexhep Murati në Fakultetin Juridik të Prishtinës veprimtarinë arsimore pedagogjike e ushtron me ndjenjën e përkushtimit dhe përgjegjësisë më të madhe, që para se gjithash pasqyrohet në mbajtjen e ligjëratave dhe të ushtrimeve me studentë, si edhe të provimeve në studimet themelore dhe studimet Master, e në veçanti në organizimin dhe zbatimin e Programit të Mësimi Klinik.

Dr. Rexhep Murati ka qenë i përfshirë në komisionet për provime me gojë të magjistraturës dhe në komisionet për mbrojtje të temave të magjistraturës dhe të temave për diplomë Master si edhe udhëheqë në cilësi të mentorit një numër të kandidatëve për magjister të shkencave juridike dhe për diploma Master. Po ashtu është mentor i një numri të doktorantëve si edhe është i përfshirë në komisionet për mbrojtje e temave të doktoratës.

Në këtë kontekst, vlen të përmendet përpjekja e tij e vazhdueshme për të avancuar metodat e mësimdhënies duke afirmuar dhe zbatuar mësimin interaktiv nëpërmjet të debateve dhe diskutimeve me studentë; duke inkorporuar edhe segmentin e mësimi praktik, aq të domosdoshëm, për përgatitjen sa më të mirë të studentëve për ushtrimin me sukses të profesionit sa me përgjegjësi aq edhe të rëndësishëm të juristit. Aktiviteti i tillë nënkupton edhe përcjelljen në grupe të gjykimeve të vërteta, analiza të rasteve konkrete gjyqësore, simulim të rasteve gjyqësore, ushtrim shikimi në shkresat e ndryshme penale si dhe përpilim të shkresave të ndryshme nga ana e studentëve. Metoda të reja të mësimdhënies, në veçanti, erdhën në shprehje gjatë zbatimit të Programit të Mësimi Klinik, koordinator i të cilit është dr. Rexhep Murati, program ky i cili është realizuar me një numër relativisht të vogël të studentëve në fushën penale dhe civile që nga semestri i dytë i vitit 2005. Këtë program që nga fillimi e kanë mbështetur ABA-CEELI-ROLI dhe USAID-i. Për shkak të interesimit të madh studentëve për Mësim Klinik dhe përkrahjes së gjerë në të cilën ai ka hasur, si në Fakultet ashtu edhe te komuniteti përkatës ligjor, ky program ka tendencë për t`u zgjeruar edhe në fusha të tjera. Si i tillë, Mësimi Klinik në

Fakultetin Juridik, bëri që të thellohet bashkëpunimi aq i domosdoshëm i Fakultetit dhe gjykatave, prokurorive dhe Odës së avokatëve nëpërmjet të angazhimit të ekspertëve të shquar të praktikës, gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve në punën me studentë për të bartur te ata njohuritë praktike dhe shkathtësitë e domosdoshme për ushtrimin e profesionit të juristit. Rezultatet e arritura në zbatimin e Mësimit Klinik kanë bërë që Zyra Amerikane përkatësisht Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë të mbështesë financiarisht një projekt të rëndësishëm për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e suksesshëm të Programit të Mësimit Klinik, që nënkupton adaptimin e një salle të gjykimit dhe disa zyrave për Mësim Klinik në godinën e Fakultetit Juridik, projekt ky që u realizuar në vitin 2007.

Dr. Rexhep Murati, në përputhje me synimin e Fakulteti Juridik për t'u integruar në familjen e madhe të universiteteve evropiane dhe më gjerë mbi bazë të standardeve bashkëkohore të arsimit universitar, bashkëpunon me profesorë të shquar nga regjioni dhe më gjerë. Si rezultat i këtyre kontakteve Fakulteti Juridik i Prishtinës në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Çikago Kentit dhe Fakultetin Juridik të Gracit organizoi dy simpoziume përkitazi me statusin final të Kosovës, një në Prishtinë më 11 dhe 12.07.2003 dhe tjetrin në Çikago më 16 dhe 17.04.2004. Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe këmbimit të përvojave profesionale, kohë pas kohe, janë ftuar profesorë eminent nga qendrat universitare të vendeve të tjera për t'u mbajtur ligjërata studentëve dhe për të debatuar me përfaqësues më të rëndësishëm të praktikës gjyqësore në Kosovë përkitazi me çështjet aktuale profesionale.

Dr. Rexhep Murati është angazhuar për reforma graduale dhe të studiuara mirë, duke ia përshtatur kushteve dhe rrethanave specifike kosovare. Ishte kundër imponimit, siç ndodhi në vitin 2000, kur në Universitetin e Prishtinës përkatësisht në Fakultetin Juridik u imponua nga faktori ndërkombëtar një model i reformës, i cili në praktikë u tregua jo i qëlluar. Për këtë arsye në vitin 2007 Senati i Universitetit të Prishtinës aprovoi planprogramet e Fakultetit Juridik të Prishtinës për studime katër vjeçare.

Dr. Rexhep Murati gjatë vitit shkollor 1997/98 mbajti mësim në Fakultetin Juridik të Tetovës (Maqedoni).

Po ashtu gjatë viteve 1999, 2000, 2004, 2005 dhe 2008 ka mbajtur ligjërata në kuadër të programeve të ndryshme për gjyqtarë dhe prokurorë, për trajnimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe të Shërbimit Policor të Kosovës.

Aktualisht mban mësim në Universitetin Fama në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë – në degën e Kriminologjikës, në studimet themelore dhe Master.

## IV

### **Veprimtaria kërkimore shkencore**

Dr. Rexhep Murati, gjatë kësaj kohe shkroi dhe publikoi një numër të konsiderueshëm të punimeve nga lëmi i së drejtës së procedurës penale dhe lëmi të tjera të së drejtës si dhe paraqiti kumtesa dhe shqyrtime në tubime të ndryshme shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto publikime janë me sa vijojnë:

### Libra dhe monografi

1. Ejup Sahiti, Rexhep Murati, E drejta e procedurës penale, 2013, Prishtinë, fq. 478. (koautor).
2. “Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja”,<sup>2</sup> Universiteti i Prishtinës- Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2006, fq. 350.
3. “Paditësi” i autorizuar në procedurën penale jugosllave”, (punim magjistrature në dorëshkrim), fq. 223.

### Artikuj

1. “Privimi nga liria dhe caktimi i paraburgimit nga ana e organeve të punëve të brendshme”; *E Drejta-Pravo*, Prishtinë, 1981, nr. 3-4, fq. 191-204.
2. “Disa çështje mbi paditësin e autorizuar në procedurën penale jugosllave”, *E Drejta-Pravo*, Prishtinë, 1983, nr. 3-4, fq. 135-156.
3. “I dëmtuari si paditës subsidiar”, Përmbledhje punimesh të Fakultetit Juridik, Prishtinë, 1986 fq. 201-216.
4. “Prokurori publik në procedurën parapenale dhe fillimi i procedurës penale”, *E Drejta-Pravo*, Prishtinë, 1988, nr. 1-2, fq. 57-72.
5. “Disa çështje mbi imunitetin penalo-procedural”, *Përparimi*, Prishtinë, 1991 nr. 2, fq. 172-184.
6. “Përsëritja e procedurës penale”, *E Drejta*, Prishtinë, 1996, nr. 2, fq. 101-109.
7. “Efikasiteti i procedurës penale dhe mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të të pandehurit në procedurën penale”, *E Drejta*, 1996, nr. 3, Prishtinë, fq. 115-132.
8. “Parathënie” përkitazi me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë të vitit 1995” - bashkautor me prof. dr. Ejup Sahitin, *E Drejta*, Prishtinë, 1997 nr. 3, fq. 143-144.
9. “Gjykimet penale politike në Kosovë, me vështrim të veçantë në disa prej atyre që u organizuan kohët e fundit në Kosovë”, *E Drejta*, Prishtinë, 1997, nr. 2, fq. 57-74.
10. “Kodi i Procedurës Penale i Kosovës” Shqyrtim teorik, *E Drejta*, Prishtinë, 2003, nr. 3-4/2003, fq. 7-36 (bashkautor me prof. dr. Ejup Sahitin).
11. “Protection of Human Rights Under Kosovo’s Criminal Code and Criminal Procedure Code”, *Chicago-Kent Law Review*, Volume 80, Number 1, 2005, fq. 99-118.
12. “Neki aspekti institucije ponavljanja krivičnog postupka zbog novih činjenica i dokaza”, *Godisnjak Pravnog fakulteta u Sarajevu*, XLIX, 2006, str. 273-290.
13. “Main Characteristics of the Judicial Criminal System in Kosovo”, *Decenium Moztanicense*, Rijeka, 2008, fq. 337-352 .
14. “Karakteristikat kryesore të sistemit gjyqësor penal në Kosovë”, *E drejta-Law* nr. 1-2, Prishtinë, 2008, fq. 49-68, i cili paraqet version të përpunuar i artikullit në gjuhën angleze me titull Main Characteristics of the Judicial Criminal System in Kosovo, në Bersilav Pavišić (ed.), *Decennium Moztanicense: Collected papers*, Fakultetit Juridik i Universitetit të Rijekës, 2008, fq.337-352.

---

<sup>2</sup> Recensentë të Monografisë janë: prof. dr. Berislav Pavišić, Fakulteti Juridik i Universitetit të Rjekës, dhe prof. dr. Ejup Sahiti, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës.

15. "Some Aspects of Human Rights and Freedoms Protection in Criminal Proceedings", *Uni percorso di studio sui diritti umani* (Prishtina 2008- Bergamo 2010, f. 198-211).

16. "Judicial kriminal sistem in Kosova and the protection of human rights and fundamental freedoms", *diritto&diritti*, 08/12/2011, f. 17. (me recension ndërlombëtar)

### **Projekt ndërkombëtar**

"Criminal Procedure System of Kosovo", bashkautor me Ejup Sahitin dhe Eduard Kunštek, ed. Berislav Pavišić, botuar në librin: "Transition of Criminal Procedure Systems", Rijeka, 2004., fq. 125-145. (*me recension ndërkombëtar*).

### **Kumtesa dhe shqyrtime**

1. "Projekt amendamentet në Kushtetutën e RSS (diskutim)", *botim i veçantë* i Institutit për Kërkime Juridike dhe Shoqërore të Fakultetit Juridik, Prishtinë 1988, fq. 223-228.

2. "Pozita, vendi dhe roli i Gjykatës Federative dhe Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e RSFJ-së së vitit 1974" - *botim i veçantë* i Institutit për Kërkime Juridike dhe Shoqërore të Fakultetit Juridik, Prishtinë, 1988, fq. 129-132. Këtë diskutim, e botoi "Rilindja" e datës 28.04.1988, në fq. 7, në kuadër të rubrikës "*Kuvendime kushtetuese*".

3. "Imuniteti penalo-procedural i delegatëve", kumtesë e paraqitur në Simpoziumin: Shqiptarët dhe Evropa dje dhe sot, i mbajtur më 23, 24, 25 e 26 maj 1991 në Prishtinë. Kumtesa, në version diç më të zgjeruar është botuar në Revistën "*Fjala*" Prishtinë, qershor, 1991 nr. 23, fq. 5.

4. "Pozita e të pandehurve shqiptarë në gjykimet penale politike", kumtesë e paraqitur në Simpoziumin e mbajtur e 10.12.1998, në Prishtinë, me rastin e Pesëdhjetë-vjetorit të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, të organizuar nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, ndërsa e botuar në *E Drejta*, Prishtinë, 1998 nr. 3-4, fq. 133-137.

5. "Personaliteti i gjyqtarëve dhe prokurorëve në ish-Jugosllavi dhe në Kosovë", ligjëratë e mbajtur më 26 tetor 1999, në Simpoziumin për gjyqtarë dhe prokurorë, të organizuar nga OSBE, në Hotelin "Grand" në Prishtinë. E botoi *Vjetari* i Shoqatës së Juristëve të Kosovës, Prishtinë, 1999, fq. 143-152.

6. "Funksionimi i sistemit gjyqësor në Kosovë si kusht për parandalimin e kriminalitetit në Kosovë", kumtesë e paraqitur më 17.12.1999, në Gjakovë në Tryezën e Rrumbullakët në temën: "*Sjelljet devijante dhe krimi në shoqërinë e pasluftës*", të organizuar nga Forumi për Iniciativë Demokratike. E botoi revista "*Demokracia*" Gjakovë, janar, 2000, fq. 24.

7. "Aktualiteti i porosive të Deklaratës së 2 Korrikut 1990 dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës të 7 Shtatorit 1990" - diskutim nga Tribuna shkencore me rastin e

10 vjetorit të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990 dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës të 7 Shtatorit 1990, mbajtur më 02.09.2000 në Fakultetin Juridik të Prishtinës, të organizuar nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.

8. “Çështja e Kosovës dhe perspektiva e zgjidhjes së statusit definitiv të saj”, kumtesë e paraqitur më 11 tetor 2000, në panel diskutimin me temën: “*E ardhmja e Kosovës*”, të organizuar nga Fakulteti Juridik i Çikago Kent në Çikago të SHBA-ve. Botoi *E Drejta*, Prishtinë, 2000, nr. 1-4, fq. 197-200.

9. “Bashkëpunimi i shteteve me Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës”, kumtesë e përgatitur për Simpoziumin me temën: “*Tribunali Ndërkombëtar për krime në ish Jugosllavi: Faktet dhe Modelet e bashkëpunimit*”, të mbajtur më 2 dhe 3 mars 2001, në Hotelin “Grand” në Prishtinë, të organizuar nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, në Prishtinë, e botuar në revistën “*E Drejta*” Prishtinë, 2001, nr. 1-4, fq. 105-120.

10. “Kushtetuta e Kosovës bazë për pavarësinë e gjykatave”, kumtesë e paraqitur, në Tryezën profesionale me temën: “*Pse Kosovës i nevojitet aktualisht Kushtetuta dhe çfarë kushtetute do të duhej të ishte*”, të mbajtur më 20.03.2001, në Hotelin “Grand” në Prishtinë, e të organizuar nga Shoqata e Juristëve të Kosovës dhe Fondacioni Friedrich-Ebert Stiftung. U botua në gjuhën angleze me titull: “*Constitution of Kosovo-A Basis for Independent Judiciary*”, në kuadër të një botimi të veçantë të këtij fondacioni që mban titullin: *Professional debate: Why Kosova Needs a Constitution Actually and What Kind of Constitution Should it Be*, Prishtinë, 2001, fq. 101-103.

11. “Kriminaliteti i organizuar në Kosovë dhe legjislacioni penal-procedural”, kumtesë e paraqitur në Konferencën Ndërkombëtare me temën: “*Gjendja e krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si edhe problemet që lidhen me të*”, e mbajtur më 12 dhe 13.12.2002 në Tiranë, botim i veçantë i Qendrës Kërkimore Studimore për Krimin e Organizuar, Tiranë, 2002, fq. 66-73.

12. “Legjislacioni proceduralo-penal në Kosovë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së”, Simpoziumi Shkencor Ndërkombëtar “*Pozita juridiko-politike e Kosovës sipas Rezolutës 1244 të KS të OKB-së*”, mbajtur më 11 dhe 12.07.2003, në Hotelin “Grand” në Prishtinë, botim i veçantë i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, me të njëjtin titull, fq. 217-225.

13. “Mbrojtja e të drejtave dhe lirive sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës”, Simpozium Shkencor ndërkombëtar, në temën: **Statusi final i Kosovës**- që u mbajt më 16 dhe 17 prill të vitit 2004 në Çikago të SHBA-ve.

14. “Aprovimi dhe zbatimi konsekuent i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale kusht me rëndësi për përmbushjen e njërit nga standardet për Kosovën”, Tryezë e Shoqatës së Ekonomistëve dhe Shoqatës së Juristëve të Kosovës, me temën: “*Standardet për Kosovën*” e mbajtur në Hotelin “Grand” në Prishtinë më 21.05.2004.

15. “Përgatitja për ushtrimin e profesionit ligjor”, Konferencë e organizuar nga Shoqata e avokatëve amerikanë/Iniciativa ligjore për Evropën Qendrore dhe Euroazinë (ABA/ CEELI), e mbajtur më 30.03.2005, në Hotel “Grand” në Prishtinë me rastin e botimit të “*Indeksit mbi reformën e profesionit ligjor për Kosovë*”.

16. “Propozimet për ndryshim dhe plotësim të KPP-së të Kosovës”, Seminar i organizuar nga ana e Departamentit të Drejtësisë i SHBA-ve në bashkëpunim me Shoqatën e Gjyqtarëve të Kosovës dhe prokurorëve të Kosovës përkitazi me ndryshimet



dhe plotësimet e KPP-së të Kosovës, mbajtur më 3-5 maj të vitit 2005 në Ohër, (Maqedoni).

17. “Fillet, zhvillimi dhe perspektiva e Mësimi Klinik në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës”, kuvendi vjetor i ABA/CEELIT, i mbajtur me 09-13 korrik 2006 në Stamboll - Turqi (bashkautor me prof. Dr. Abdullah Aliun dhe mr. Iliriana Islamin).

18. Diskutim në tryezën përkitazi me Draftin e Marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë, të organizuar nga Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara –Zyra e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, të mbajtur me 20 mars 2007, në ndërtesën “Gorenje në afërsi të Prishtinës.

19. Hibridni Pravosudni krivični sistem na Kosovu, në kolokviumin shkencor ndërkombëtarë, *Quo vadis jus kriminale* i cili është mbajtur në Rjekë me 5. 04. 2008, në Republikën e Kroacisë me rastin dhjetëvjetorit të Institutit për shkencat penale të Moshqenices të Fakultetit Juridik të Universitetit të Rjekës,

20. Zhvillimi i mësimi Klinik në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, në Tryezën mbi Avokatinë dhe Arsimin Ligjor në Kosovë, të organizuar nga Shoqata e Avokatëve Amerikan /Iniciativa për Sundimin e Ligjit – ABA/ROLI, në Kosovë, në hotel Grand, me 19 qershor 2008.

21. *Planprogramet dhe metodologjia e mësimdhënies në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës*, me rastin e publikimit të Indeksit të Reformës së Arsimi të lartë në Kosovë 2008, të organizuar nga Shoqata e Avokatëve Amerikan /Iniciativa për Sundimin e Ligjit – ABA/ROLI, në Kosovë, në hotel Grand, me 22 tetor 2008.

22. *Disa aspekte të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në procedurën penale*, kumtesë e paraqitur në Konferencën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me titull: “Deklarata Universale për të drejtat e njeriut: Rasti i Kosovës” të mbajtur me 23 dhe 24 tetor 2008, në hotelin Grand në Prishtinë

### Recensione dhe vështrime

1. “Nga Këshillimi i njëzetvjetorit të Shoqatës për të drejtën penale dhe kriminologjinë”, *E Drejta-Pravo*, Prishtinë 1981, nr. 1-2, fq. 121-126.

2. “Dr. Milica Stefanović-Zlatić: Privilegjet e të pandehurit në procedurën penale jugosllave”, *E Drejta-Pravo*, Prishtinë, 1982, nr. 3-4, fq. 181-185.

3. “Mr. Ejup Sahiti: E drejta e procedurës penale” *E Drejta-Pravo*, Prishtinë, 1983, nr. 1-2, fq. 135-149.

4. “Nga mbledhja interkatedrale e katedrave penale”, *E Drejta - Pravo*, Prishtinë, 1983, nr. 3-4, fq. 219-224.

5. “Dr. Ragip Halili: Krivične sankcije po običajnom pravu na Kosovu”, *Jugoslovenska Revija za Kriminologiju i Krivično Pravo*, Beograd, 1986 nr. 3-4, str. 179-183.

6. “Vështrim nga mbledhja e katedrave penale”, *E Drejta - Pravo*, Prishtinë, 1986, nr. 3-4, fq. 243-248.

7. “Mbledhja interkatedrale e katedrave të shkencave penale juridike të fakulteteve të Jugosllavisë”, *E Drejta- Pravo*, Prishtinë, 1989, nr. 1-2, fq. 71-76.

**Punime të tjera**

1. “Nga jeta shkencore në Fakultetin Juridik”, *E Drejta – Pravo*, Prishtinë, 1984, nr. 1-2, fq. 115.
2. “Delegatët kosovarë kanë imunitet”, *Shkëndija*, Prishtinë, 1990, nr. 32, fq. 12
3. ”Tri vjet pas përjashtimit të dhunshëm nga lokalet e Fakultetit Juridik të Prishtinës”, *E Drejta*, Prishtinë, 1995, nr. 1. fq. 9-12.
4. “Kthimi në Fakultetin Juridik në Prishtinë pas tetë vjetësh”, *E Drejta*, Prishtinë, 1999 nr. 1-2, fq. 7-14.

Dr. Rexhep Murati, profesor i rregullt

---

Prishtinë  
14. 04. 2014